



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 mars 2015, në mbledhjen e XV-të (pesëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, drejtorët e Drejtorive komunale, përveç z. Abaz Llugaliu drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë i cili mungoi, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen dhe shtoi, konsideroj se rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë. Ju njoftoj se sot drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z. Abaz Llugaliu ka pasur një takim zyrtar me nivelin qendrorë, mirëpo lidhur me pyetjet e bëra në mbledhjen e kaluar nga z. Lutfi Rexhepi dhe z. Haki Rudari, drejtori i cekur përgjigjet i ka përgatitur dhe u janë dhënë këshilltarëve të cekur, andaj konsideroj se mund të vazhdojmë me punë.

z. Haki Rudari, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve nga Lëvizja Vetëvendosje është hera e tretë që kemi kërkuar një pikë të rendit të ditës, dhe atë, informatë nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, konkretisht për ish “Hotel Llapin” dhe “Banka për Biznes”, pikë të cilën nuk e kam kërkuar vetëm për vete, por konsideroj se është në interes të gjithë këshilltarëve dhe të gjithë qytetarëve, andaj meqë sot kemi shumë pika për të shqyrtuar, propozoj që pika e cekur në të ardhmen të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës.

Gjithashtu propozoj që sot në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe pika, formimi i dy Komiteteve të reja përkatësisht, Komiteti për Bujqësi, dhe Komiteti për Shërbime Publike, dhe njëkohësisht kërkoj funksionalizimin e tyre dhe Komiteteve tjera sepse të gjithë jemi në dijeni se asnjëherë Komitetet tjera të cilat i kemi formuar në këtë Kuvend nuk janë funksionalizuar.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne sot kemi një rend dite me shumë pika dhe nuk mendoj se do të ishte e arsyeshme të përfshijmë edhe pika shtesë, parafolësi e kërkoi një informatë e cila veç iu është dhënë ati, kurse për propozimin tjetër

mendoj se në një mbledhje të ardhshme mund ta shqyrtojmë atë, mirëpo në pikën të ndryshme mund të paraqitni pyetje apo të propozoni pika për mbledhjen e radhës. Andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit u konstatua se me 32 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit më 04 shkurt 2015 dhe 27 shkurt 2015

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 04 shkurt 2015.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 27 shkurt 2015.

3. Raporti Financiar për vitin 2014

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju njoftoj se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa pas debatit dhe analizave që kemi bërë në lidhje me këtë raport, i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo para se të fillojmë me diskutime, fjalën ia jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të paraqesë fjalën hyrëse, edhe pse të gjitha janë në material, konsideroj se nuk është e tepërt të paraqitet në pika të shkurtra edhe një fjalë hyrëse.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, raporti financiar për vitin 2014 është i hartuar mirë dhe shpreh nivelin e kënaqshëm të arritjes së pikësnyimeve për vitin 2014. Nga tabela në tabelë shohim një pasqyrë reale të shpenzimeve dhe realizimit afër 100% të buxhetit përkatës. Po ashtu është në interes të zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës edhe numri i ndryshëm i operatorëve të cilët realizuan projektet të ndryshme. Andaj për këto dhe shumë arsye tjera ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë raport.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së ne kemi diskutuar për këtë raport dhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i ka përshkruar ashtu siç janë bërë pagesat, mirëpo e jona është të shqyrtojmë formën e pagesave për projektet e përfunduara. Unë në atë mbledhje kam bërë disa pyetje dhe kam kërkuar nga drejtorët e Drejtorive përkatëse që sot të na japim përgjigje reale rreth pagesave që janë bërë. Përshtypje të madhe më ka bërë që janë planifikuar të hyra nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim 60,000.00 €, kurse nga të gjitha ato prona janë inkasuar vetëm 42,000.00 €, gjë e cila më së miri tregon se Komuna e Podujevës ka një buxhet të varfëruar për shkak të keqpërdorimeve të punëve komunale, e them këtë ngase mua më është dorëzuar një listacion prej 102 pronave komunale të cilat janë të dhëna në shfrytëzim dhe të nga të cilat po të ishin inkasuar vetëm 20 € në muaj do të arrihej një shumë më e madhe se sa ajo që është planifikuar, pra nga kjo mendoj se duhet të vihet në rend trajtimi i pronës komunale. Gjithashtu përshtypje më ka bërë edhe ndërtimi i

rrugëve ku në këtë kod janë paguar 2,838,804.00 €, kurse drejtori i DBF në mbledhjen e KPF-së më ka dhënë një përgjigje verbale për rrugët e shtruara në Komunën tonë, mirëpo ne të gjithë jemi në dijeni se një kilometër asfalt i standardit të mirë mund të kushtoj rreth 70,000.00 € deri në 72,000.00 €, andaj nëse në territorin e Komunës së Podujevës janë shtruar 20 kilometra me asfalt të kualitetit të lartë në rrugët rajonale prapë nuk përputhet kjo shuma e paguar, ndërsa ne jemi në dijeni se në Komunën e Podujevës janë shtruar rrugë lokale në fshatra apo edhe në lagje të vogla të qytetit me më së shumti diametër 4 metra, kështu që mendoj se këto pagesa janë të pa arsyeuara, dua të përmendi vetëm një rrugë në fshatin Revuq e cila është asfaltuar në muajin nëntor 2014 kurse tani për tre muaj është dëmtuar dhe është shkapërderdhur i gjithë asfalti, e pyes drejtorin e Drejtorisë përkatëse, konkretisht sa kilometra rrugë janë shtruar me asfalt në Komunën e Podujevës, sa segmente, dhe sa prej tyre kanë qenë rrugë rurale, në mënyrë që të barazojmë shumën e paguar prej 2,838,804.00 €. Lidhur me gjatësinë dhe pagesat për rregullimin e trotuareve unë kam marrë një përgjigje në mbledhjen e KPF-së, mirëpo përshtypje të madhe më ka bërë edhe sa i përket pajisjeve speciale mjekësore ku në vitin 2013 janë paguar rreth 45,000.00 € kurse në vitin 2014 janë paguar 49,850.00 €, e që ne të gjithë jemi në dijeni se si qëndron gjendja në qendrat e mjekësisë familjare në Komunën e Podujevës, ku unë personalisht para një muaji kam qenë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në shoqërim të një të afërmi dhe më është dashur të blejë fashë, kurse në këtë raport figurojnë afër 50,000.00 € pagesa për pajisje speciale mjekësore. Preokupim tjetër për dëmtim të këtij buxheti janë edhe pagesat gjyqësore të cilat në vitin 2014 janë rritur, përkatësisht janë paguar 148,900.00 € për vendime të dhunshme me aktvendim të formës së prerë të Gjykatës për mos përfillje të procedurave të prokurimit dhe ekzekutim të penaltive për subjekte të cilat nuk e kanë kryer punën ashtu si duhet, andaj nuk di si mund të përkrahet ky raport financiar nga grupi i këshilltarëve nga subjekti i cili qeverisë në këtë Komunë, ku janë paguar afër 200,000.00 € për vendime të Gjykatave kurse nuk është ekzekutuar asnjë penalti ndaj kompanive të cilat nuk e kanë kryer punën si duhet, siç është rasti i fshati Revuq, nuk është siguruar asnjë garancion bankarë për kompani të cilat kryejnë punë dhe nuk ka pranuar asnjë dokument nga Drejtoria përkatëse si garancion nga kompanitë për punët e kryera dhe për mjetet e futura në punë. Kështu pra Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës i kundërshton këto pagesa në tërësi dhe do t'i trajtoj edhe me masa tjera të cilat nuk kanë arsyetim financiarë ngase sipas këtij raporti na dalin se në Komunën tonë janë shtruar 30 deri në 40 kilometra asfalt kurse sipas incizimeve tona që kemi bërë asnjë rrugë nuk del më e madhe se 3.5, ku pothuajse të gjitha kanë filluar të demolohen pas tre – katër muajve.

I nderuari Kryesues i Kuvendit, është shumë e pakuptimtë që afër pesë muaj kemi kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, i cili ka nxjerrë vendim për largimin e rrethojave në prona të uzurpuara kurse Drejtoria e Inpeksionit nuk ka arritur asnjëherë ta ekzekutoi atë vendim, për të cilin mendoj se nuk ka vullnet as ekzekutivi, por që duhet përmes Gjykatës të ndërmarrit një masë tjetër në mënyrë që ai vendim të ekzekutohet. Pastaj ne vazhdimisht kemi kërkuar listën e të gjitha pronave komunale dhe vendimet e dhënies në shfrytëzim të atyre pronave, pra e kemi kërkuar këtë sepse jemi në dijeni se të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim me Ligjin e mëparshëm duhet të sjellën në Kuvendin e Komunës për tu shqyrtuar sipas ligjit të ri i cili është në fuqi, gjë e cila nuk ka ndodhur asnjëherë, andaj të gjitha ato prona të dhëna me

qira janë në kundërshtim me ligjin sepse janë dhënë pa vendim të Kuvendit apo në mënyrë individuale, kështu që unë mendoj se drejtori i cekur nuk ka kurrfarë arsye që sot të mos jetë prezent në këtë mbledhje për t'i dhënë sqarimet e nevojshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e pronave komunale. Çështja tjetër që është shqetësuese ka të bëjë me inkasimin e taksës në shumë 3 euro për legalizimin e ndërtimeve pa leje e që jemi e vetmja Komunë në Kosovë që e kemi aplikuar këtë taksë, e që mendoj se është shumë e padrejtë kjo sepse ky projekt është i nivelit qendrorë dhe i përkrahur edhe nga vendet e rajonit. Mjete e inkasuara nga ajo taksë figurojnë në këtë raport, por vendimin për të aplikuar atë pagesë nuk jam në dijeni se kush e ka marrë dhe kush ka thënë se qytetarët duhet të paguajnë taksën e cekur legalizimin e ndërtimeve pa leje.

z. Haki Rudari, theksoi, edhe për ne Grupin e këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje raporti vjetor financiar paraqet një dokument të rëndësishëm për Komunën, ku mënyra e planifikimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së tij ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të Komunës tonë dhe në zhvillimin e tërësishëm. Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Podujevë së bashku me Grupin e këshilltarëve e ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të veçantë raportin financiar për vitin 2014. Ky raport financiar ka shumë mangësi apo edhe dilema të shumta nëpër kode të ndryshme. Gjithashtu pasqyrat apo kodet e paraqitura nga Drejtoritë e Administratës shprehin shpenzime të paarsyeshme si dhe shpërndarje jo të mirë të mjeteve. Grupi i këshilltarëve të LVV-së mendon se menaxhimi më i mirë i këtyre projekteve nga ana e ekzekutivit apo qeverisjes komunale do të ndikonte për një jetë më të mirë të qytetarëve edhe ashtu të rënduar. Këtë raport financiarë nuk e kritikojmë vetëm nga aspekti politikë si opozitë, por mendojmë se ky raport duhet të jetë më i saktë dhe më konkret sa i përket shpenzimeve të ndryshme si dhe duhet të jetë më i specifikuar. Sa i përket përqindjes së shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2014 është mjaft e kënaqshme, por në të njëjtën kohë për ne është shqetësuese ku nëntëmujori i parë i vitit 2014 kishte një realizim për 35% për investime kapitale e ku dihet që kërkesat e qytetarëve janë të shumta në të gjitha sektorët apo sferat e jetës. Të nderuar kolegë, se mirëqenia e qytetarëve të Komunës së Podujevës është shumë e rëndë, e dëshmoi edhe eksodi i madh i qytetarëve në muajt e fundit dhe në bazë të numrit të nxënësve që janë dhënë në media ndoshta jemi Komuna më e prekur në këtë drejtim. Gjatë kësaj kohe ne kemi biseduar me qytetarë të shumtë dhe të gjithë njëzëri janë shprehur se e tëra kjo është duke ndodhur si pasoj e gjendjes së rëndë ekonomike. Prandaj për ne është shumë shqetësuese dhe e shtroi si pyetje, pse asnjëherë Kryetari i Komunës apo drejtorët e Drejtorive të Komunës nuk ka dalë të bisedojnë me qytetarë dhe sado pak të kontribuojnë në ndaljen e tyre, ndërsa për fat të keq në përvjetorin e partisë në pushtet u mblodhën i madh e i vogël, gjë e cila mendoj se është për tu analizuar. Edhe në vitin e kaluar kemi kërkuar një plan të punës nga ana e Drejtorive, por kjo nuk ka ndodhur, prandaj kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës që në qoftë se e kanë atë plan të na e paraqesin atë, por si duket ky Ekzekutiv është duke punuar vetëm ad-hoc. Gjatë vizitave të shumta që kemi bërë në fshatra dhe lagje të ndryshme, ankesat e qytetarëve ishin të shumta drejtuar qeverisjes komunale për mos përmbushje të detyrave që janë në interes të tyre, shembull, në fshatrat Batllavë, Gërdoc, Lupç, Surkish, Siboc, Sfeqël e të tjera. Po ashtu kemi ankesa të shumta si pasoj e vërshimeve dhe mosinteresimin e qeverisjes komunale për t'ju ndihmuar qytetarëve, dhe më duhet të ceku se në vitin e kaluar kur kemi debatuar për vërshimet, premtimet e kësaj qeverisjeje kanë qenë të shumta. Ne kemi vizituar edhe shkolla të ndryshme ku ankesat e prindërve,

nxënësve, mësimdhënësve janë të mëdha veçanërisht në ato shkolla të cilat janë afër rrugëve magjistrale apo ku frekuentimi i automjeteve është shumë i madh, andaj shtroj pyetje, çka është ndërmarrë për këtë çështje në fshatrat, Shajkoc, Batllavë, Llugë Gllamnik e të tjera ku të gjithë nxënësit janë të rrezikuar për çdo ditë, dhe të kujt janë ata nxënës dhe për çka jemi ne dhe Ekzekutivi i Komunës, kujt duhet t'ju shërbejmë.

Në vazhdim do t'ju paraqes disa rritje të shpenzimeve sipas kodeve të ndryshme, rritje të cilat për ne janë plotësisht të paarsyeshme;

Kodi 13760, Dru 111,448.45 €, kurse në vitin 2013 shuma ishte 81,185.46 € e që i bie 37.28% rritje, gjë e cila për ne është shumë shqetësuese sepse në vizitat që kemi bërë në shkolla të ndryshme asnjë drejtor i shkollës nuk ka qenë në gjendje të tregoi çmimin e blerjes së një metri dru dhe ato nuk ekzistojnë në faturat e lëna në shkolla, pyetje të cilën e shtrojmë edhe për furnizim me derivate të naftës. Pastaj furnizime për zyre shuma 103,658.76 €, nuk jemi në dijeni se çka janë ato dhe duhet të specifikohen se cilat janë ato furnizime sepse kemi të bëjmë me një shumë jo të vogël të mjeteve financiare.

Kodi 31900 Kapital tjetër 307,880.82 €, edhe për këtë nuk jemi në dijeni se çfarë kapitali bëhet fjalë, prandaj edhe bëra vërejtje sepse kur të vie një raport i tillë duhet të jetë më konkret sa i përket shpenzimeve të buxhetit. Pastaj në raport kemi edhe shumën prej 148,940.73 € për pagesa të vendimeve gjyqësore e cila ka rritje të madhe në krahasim me vitin paraprak dhe për këtë kërkojmë sqarime nga Ekzekutivi i Komunës, po ashtu kemi shpenzime të shumta për furnizim, ushqim dhe pije, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve. Gjithashtu realizimi nga të hyrat vetanake mbetet çështje shqetësuese ngase inkasimi nuk është i kënaqshëm përveç tatimit në pronë që është edhe i kushtëzuar. Pra ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV mendojmë se qytetarët e Komunës së Podujevës meritojnë një menaxhim dhe shpenzim të buxhetit më të mirë nga ana e Ekzekutivit të Komunës në projekte të cilat janë në interes të qytetarëve, dhe ajo që dua të them në fund është se Komuna e Podujevës nuk merret fare me bujqësi kur kemi parasysh se të hyrat nga ky sektor janë të shumta.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, qeverisja e mirë karakterizohet nga 8 komponentë apo parime dhe konsiderohet efikase kur ato të jenë përmbushur, ku përfshihen; pjesëmarrja, konsensusi, përgjegjësia dhe llogaridhënia, transparenca, efikasiteti, paanshmëria, zbatimi i ligjit si dhe sigurimi në luftimin e minimizimit të korrupsionit duke marrë parasysh edhe interesat e grupeve të pa favorizuara të shoqërisë. Pyetja dhe dilema është se a janë siguruar këto parime në qeverisjen tonë lokale dhe se ky raport financiar a prezanton përgjegjësi, transparencë, efikasitet, zbatueshmëri të ligjit dhe a e minimizon korrupsionin, a është ky buxhet shpenzues apo zhvillimorë. Përshtypja jonë është se ky buxhet edhe pse jo i mjaftueshëm për një Komunë siç është kjo e Podujevës, nuk ka arritur të shpenzohet veçanërisht në dy segmente kryesore të cilat kanë impakt në zhvillimin ekonomik, dhe atë, në investime kapitale dhe në subvencione, ku në investime kapitale janë realizuar 88.97 % të investimeve ndërsa në subvencione 91.12 %.

Nuk dua sot të foli për përgjegjësit ose papërgjegjësitë ligjore, për çka janë të humbura rreth 170,000.00 € me vendime gjyqësore, për shifra të cilat kanë shpërputhje të dukshme veçanërisht kur krahasohen me raporte të tjera vjetore dhe periodike, për shpenzime të derivateve të lëngëta dhe të ngurta për ngrohje, duke përmendur dilemën ku në oborrin e deponisë e cila gjendet në fshatin Peran muaj më parë ishte gati e stërmbushur kurse tani është shprazur, dhe as për subvencione të etnive jopublike, por dua të vë theks të veçantë në ato dy kategori që i përmenda më parë e të cilat kanë

impakt në zhvillimin ekonomik. Në investimet kapitale 19% e buxhetit apo 1,189,690.00 € janë investuar gjegjësisht i janë dhuruar asete kompanisë publike profitabile Ujësjiellësit Prishtina, kompani e cila në çdo fund të muajit i faturon qytetarët dhe inkason mjete financiare nga qytetarët, çështja tjetër është se, si ka mundësi që nga shuma e ndarë për subvencione kur Komuna jonë ka këtë shkallë të zhvillimit ku të gjithë ankohemi se është shumë e pamjaftueshme, kurse shpenzohen vetëm 91% e asaj shume, kurse ne sigurisht që të gjithë pajtohemi se sikur të kishim edhe dhjetëfishin e kësaj shume për subvencione nuk do të mjaftonin ndërsa edhe kjo shumë që është aktualisht nuk arrin të realizohet në tërësi. I shtroj pyetje Kryetarit të Komunës, a ka siguruar mekanizëm të kontrollit që subvencionet e ndara të shkojnë në destinim të duhur dhe që të mos mund të shpërdorohen, gjegjësisht a keni dëgjuar zotëri Kryetar që disa përfitues të subvencioneve qoftë në fidane ose pajisje të tjera, ato subvencione nuk i posedojnë më.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket këtij raporti u përmenden po thuajse të gjitha nga parafolësit, mirëpo unë mora fjalën rreth një çështjeje e cila më ka bërë përshtypje jo të mirë, konkretisht për shpenzimin e mjeteve në kodet, pajisje tjera dhe kapitale tjera, përkatësisht kodi 13509 ku thuhet pajisje tjera deri në njëmijë euro e që në fakt janë të shpenzuara 22,000.00 € e që i bie se janë blerë minimum 22 pajisje për të cilat nuk ka specifikime e as argumente se çka janë ato, mandej kemi kapitale tjera 307,000.00 €, pajisje 1500.00 € e të tjera, ku në total del një shumë 428,690.00 €, shumë e cila është e pambuluar dhe e padefinuar, çështje për të cilën mendoj se është shumë shqetësuese dhe e tepërt ngase afër një gjysmë milioni të shpenzuara nuk janë të argumentuara.

Gjithashtu e kam ngritur dhe dua të ngris prapë çështjen që ka të bëjë me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve ngase në çdo raport financiar kemi gjendje të njëjtë ku vërehet një diskrepancë apo mospërputhje sa i përket kësaj çështjeje, jam në dijeni se janë shpenzuar 75,000.00 € për blerjen e automjeteve zyrtare por nuk jam në dijeni se a duhet apo jo t'ju nënshtrohen regjistrimit ato automjete, mirëpo vërehet një rritje prej 38% sa i përket regjistrimit të automjeteve përkundër që për sigurimin e automjeteve kemi një rënie prej 28%, andaj pyes, si ka mundësi të ndodh kjo, dhe të përsëritet në çdo raport.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, do të përpiqem të japë përgjigje disa pyetjeve që kanë të bëjnë me DSHPMSh, por para së gjithash ju them se ne kemi bërë përpjekje maksimale që buxheti i destinuar në këtë Drejtori të jetë i shpenzuar në mënyrë racionale dhe në Projektet të cilat janë miratuar në këtë Kuvend. U tha këtu se nuk ka pasur plan të punës, mirëpo unë mendoj se projektet e miratuara me projektbuxhetin e Komunës i miratuar në Kuvend është plan-program i punës dhe ne u jemi përmbajtur 100% të gjitha atyre projekteve të miratuara dhe të ridestinuara. **z. Rafet Llapashtica** bëri pyetje rreth trotuareve, unë pa u lëshuar në çështje teknike dhe operacionale them se rreth 280,000.00 € të shpenzuara në trotuare është gjë e mirë që është bërë ngase është ngritur struktura e investimeve në trotuare dhe se nevojat janë të mëdha posaçërisht rreth shkollave afër rrugëve magjistrale dhe atyre regjionale, pra ka qenë një kontratë dy vjeçare 2013-2014 në shumë rreth 211,000.00 € e cila është realizuar në rrugët magjistrale; rruga e fshatit Balloc, rrugët në Podujevë "Ali Ajeti", "Fahri Fazliu", oborri në hapësirat e Shërbimit të Zjarrëfikjes, gjithashtu trotualet në rrugët e fshatrave Peran, Letanc, Batllavë, Obranqë, Shtedim e të tjera, ku disa prej tyre edhe pse janë rrugë regjionale në kompetencë të nivelit qendrorë ne kemi ndërhyrë në ato rrugë për shkak të rrezikshmërisë së madhe posaçërisht të nxënësve, po ashtu në atë kontratë përfshihen edhe disa rrugë me kubëza brenda qytetit

dhe në rrugën afër varrezave. Sa i përket borxhit publik mund t'ju them se ai është shumë i vogël 3,146.00 € dhe se të gjitha kontratat që kanë përfunduar gjatë vitit fiskal janë paguar. Gjithashtu kontratat dy vjeçare që kanë qenë janë mbuluar mbi 90% me buxhetin e këtij viti dhe të vitit të kaluar, pastaj shpenzimet brenda Drejtorisë për investime kapitale janë 99.3%. Lidhur me pyetjen e z. Haki Rudarit rreth kompensimeve nga vërshimet, e kemi cekur edhe më parë se kompensimet për dëmtimin e pronave private, për fat të keq nuk kemi ligj që e rregullon këtë çështje, pra është problem që është diskutuar disa herë mirëpo kompensime deri më tani nuk ka pasur. Pastaj pati një pyetje nga z. Lutfi Rexhepi i cili e tha se u janë dhuruar asete kompanisë regjionale Ujësjiellësi Prishtina, ne këtë gjë e kemi diskutuar disa herë dhe prapë ju them se nuk u janë dhuruar asnjë herë asete asnjë kompanie regjionale, në kompaninë Ujësjiellësi Prishtina megjithatë ka aksione edhe Komuna e Podujevës, por për fatin e keq kjo kompani nuk ka mbikëqyrje për mirëmbajtjen e kanalizimeve në territorin e Komunës tonë ngase së pari nuk ka kapacitete vetë kompanie, pastaj nuk ka rrjetë të ujësjiellësit në të gjitha fshatrat kjo kompani, andaj nuk mund të bëhen kompensime, inkasime dhe mirëmbajtje të rrjetit në të cilin nuk ka qasje të ujit, andaj ky është problemi që diskutohet për kompanitë regjionale. Për çka do që ndokush është i interesuar mund të vie në Zyrën time dhe unë jam i hapur për të bashkëbiseduar dhe sqaruar çështje të ndryshme sa i përket projekteve të përfunduara. Lidhur me cilësinë dhe standardit të punimeve mund t'ju them se nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe kompanitë janë ato që janë dhe ju mund të na ndihmoni në këtë drejtim në mënyrë që cilësia e punimeve të jetë sa më kënaqshme, mirëpo përgjegjësia sa i përket shpenzimit të parasë publike është e rregulluar me ligj dhe asaj nuk mund t'i ikim askush, prandaj ne gjithnjë mundohemi të jemi sa më korrekt në aspektin e shpenzimeve publike.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, mora fjalën që t'i jap disa përgjigje rreth disa pyetjeve të disa këshilltarëve parafolës. Sa i përket shumës së shpenzuar nga ana e Drejtorisë që unë jam drejtor, ato kanë qenë kontrata transparente dy vjeçare për vitet 2013-2014 e që kanë vazhduar dhe kanë përfunduar në vitin 2014 ku edhe janë bërë pagesat, gjithashtu kemi kontrata të lidhura në bazë të projekteve të miratuara në këtë Kuvend dhe sipas planit të dinamikës së asfaltimit të rrugëve në fshatra të Komunës së Podujevës ku për shkak të mungesës së mjeteve financiare janë proceduar edhe ato në kontrata dyvjeçare. Andaj kushdo që e sheh të arsyeshme dhe që ka dëshirë, unë jam i gatshëm t'ia ofroj të gjithë materialin e lëndës secilit prej jush. Sa i përket procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje përkatësisht pagesës prej 3 € nga ana qytetarëve, është e vërtetë që e kemi aplikuar këtë taksë, jemi konsultuar edhe me Drejtoritë tjera dhe arsyeja e kësaj ka qenë se çështja e sistemit ka qenë e tillë, dhe ne si Drejtori kemi bërë kërkesë në Ministrinë përkatëse që të na përkrah në aspektin buxhetor për shkak se nuk kemi mundësi të punësojmë staf me kontratë mbi vepër ose bashkëpunëtorë nga jashtë sepse kërkesat kanë qenë të mëdha dhe afati ka qenë i shkurtë, pastaj unë kam qenë ai i cili nuk kam dashur që lëndët e qytetarëve t'i pranoj pa i protokolluar në mënyrë që në të ardhmen të ketë dëshmi secila palë që ka aplikuar por edhe që ne të kemi arsyetim dhe të dokumentojmë në mënyrë faktike, dëshiroj t'ju njoftoj se ne kemi marr vendim dhe i kemi njoftuar të gjithë qytetarët dhe mjetet e informimit se shuma e pagesës 3 € që kanë paguar qytetarët do t'iu kompensohet në fazën e dytë të procesit të legalizimit të objekteve pa leje, fazë e cila fillon me 15 shtator 2015, përkatësisht shuma e cila është e përcaktuar për taksë 100 €

që duhet ta paguajnë qytetarët do t'iu zbritet për 3 € që do të thotë se qytetarët do të paguajnë taksën vetëm 97 €, pra kjo është gjithë ajo që ka ndodhur në Komunën e Podujevës dhe kjo është gjendja faktike – reale si dhe mënyra e kompensimit që do t'ju bëhet qytetarëve të cilët kanë paguar taksën 3 € për procesin e legalizimeve pa leje.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, lidhur me përgjigjet e drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit sa i përket kompanive publike regjionale unë jam në dijeni se Komuna e Podujevës është aksionare në ato kompani, mirëpo unë e shtrova pyetjen në kontekstin e logjikës ekonomike, gjithashtu jam në dijeni se edhe Kryetari i Komunës ka përgjegjësi para qytetarëve të kujdeset për ujin, kanalizimet, e të tjera, mirëpo a shtrohet nevoja që të gjendet zgjidhje tjetër sepse në qoftë se ne për çdo vit bëjmë investime nga rreth 1 milion euro në këto gjëra, sigurisht se shtohet nevoja që të mendojmë të gjejmë ndonjë zgjidhje tjetër në këtë aspekt sepse realisht investimet tona në këto gjëra do të merren, këtë e them sepse kompanitë janë shumë të kujdesshme kur bëhet fjalë për faturimin dhe inkasimin e mjeteve, dhe unë asnjëherë nuk kam hasur në ndonjë kompani publike regjionale e cila ka bërë raport rreth punës së tyre, si dhe nuk jam në dijeni se këto kompani bëjnë ose nuk bëjnë pjesë me mjete financiare në buxhetin e Komunave përkatëse apo vetëm janë përfituese nga buxhetet e Komunave aksionare.

znj. Kumrie Hoti, theksoi, sa i përket raportit financiar për vitin 2014 më duhet të ndalem tek disa të dhëna që mendoj se është dashur të përfshihen në raport sepse të gjitha ato kanë implikime buxhetore. Të gjithë ne jemi në dijeni që mekanizmi kryesor i cili është mbikëqyrës për shpenzimet e bëra dhe i cili përkujdeset për shpenzimin e drejtë dhe efektiv të parasë publike, duke u fokusuar edhe në vlerën e arritur për shumën e parave të shpenzuara është Auditori i Brendshëm. Duke u bazuar në raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013, për gjetjet dhe rekomandimet e dhëna për Komunën e Podujevës mendoj se ne si përfaqësues të popullit është dashur të jemi të njoftuar për planet e Auditorit të Brendshëm dhe Komunës në përgjithësi lidhur me adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, kurse ne nuk kishim një plan veprimi, e aq më pak një raport të realizimit të aktiviteteve të parapara nga Auditori i Brendshëm.

Raporti kishte rezultuar me 10 të gjetura dhe rekomandime ku mes tjerash thuhej se Komuna e Podujevës është në mesin e 10 Komunave me më së shumti obligime të papaguara financiare dhe për këtë shtroj pyetje, nëse në vitin 2013 obligimet e papaguara kishin rritje për 31%, sa janë ato obligime në vitin 2014, pra a kemi rritje apo kemi zbritje, dhe pse. Gjithashtu gjetja tjetër ishte edhe shkalla e ulët e mbledhjes së arkëtueshmeve dhe tani duhet të shohim se a ka pasur përmirësime dhe nëse jo atëherë ne duhet ta dimë pse. Pastaj ka pasur parregullsi në dosje të tenderit dhe në respektim të procedurave tenderuese me rastin e tenderimit për investime kapitale, ne nuk kishim një raport nga zyra e prokurimit për dinamikën e realizimit të projekteve por e kemi rastin konkret të fillimit të dëmtimit të rrugëve të asfaltuara së fundmi në fshatin Revuç ku rruga e asfaltuar në muajin tetor –nëntor të vitit 2014 tani është prishur pothuajse në përgjithësi, dhe ne duhet informohemi se a është kërkuar garanci për punimet e kryera dhe a është bërë pranimi teknik i rrugës, nëse po mbi cilat parametra, si dhe të sqarohet pse është prishur. Nëse janë bërë pagesa në bazë të vendimeve Gjyqësore në vlerë 44,000.00 €, cilat janë masat ndëshkuese që janë zbatuar kundrejt operatorëve të papërgjegjshëm ekonomik, siç është rasti për rrugën e fshatit Revuç, dua të them, pse nuk kemi garancion të asaj rruge dhe pse është kryer punë e papërgjegjshme. Pastaj shtrohet pyetja, se cilat ishin ato vendime ose veprime të cilat i kanë marruar departamentet ose

institucionet tona e që në momentin e kontestimit të tyre para organeve të Gjyqësore janë humbur ato konteste, si ka funksionuar departamenti jonë ligjorë kjo i bie se është shkelur ose më mirë të them nuk janë zbatuar si duhet dispozitat ligjore.

z. Flakron Gashi, theksoi, me vëmendje e përcjella shtjellimin rreth paraqitjes së raportit financiar për vitin 2014 që e bënë disa drejtorë të disa Drejtorive të Komunës, askush nuk e konteston pse është bërë forma tabelore e raportit brenda periudhës ligjore, ngase fundja kjo është obligim ligjor i organeve përkatëse, mirëpo nuk është aftësi e një qeverisje të mirë nëse buxheti vetëm arrin të shpenzohet në përpikëri ose në masën 97% - 98%, por është me rëndësi që këto shpenzime në çfarë mënyre dhe ku drejtohen, si dhe në çfarë masa ndikojnë në përmirësimin e drejtpërdrejt të jetës së qytetarëve, dua të marr një shembull por njëkohësisht le të vlen edhe si pyetje për ata drejtor në fushën e të cilëve hynë, furnizime mjekësore në vlerë 77,285.10 €, kodi 13630, ndërsa shpenzime për karburant për vetura është 96,000.00 €, pra kjo tregon përkujdesjen dhe vizionin që kemi ndaj qytetarëve, dhe mos të harrojmë që ne kemi një Komunë me rreth 89 mijë banorë dhe për shpenzime mjekësore të alokohen ose shpenzohen vetëm 77,285.10 €, ndërsa karburant për vetura 96,000.00 €, kjo është një disproporcion i madh dhe një amulli e madhe, dhe pyes drejtorin përkatës, sa është numri i veturave zyrtare të cilat e shpenzojnë këtë karburant. Çështja tjetër, pajisje speciale mjekësore në vlerë afër 50,000.00 €, pastaj vetura zyrtare 75,000.00 €, dhe tani pyes, a më rëndësishëm është shëndeti i qytetarëve ku pikë së pari janë të preokupuar fëmijët tanë, motrat tona nënat tona që janë barra sociale e familjes, apo komoditeti i zyrtarëve komunal që ata të voziten me vetura më të shtrenjta dhe më të reja, gjë për të cilën mendoj se nuk është në rregull. Pastaj çështja tjetër, naftë për ngrohje qendrore, qymyr, dru, derivate për gjenerator ku të gjitha këto arrijnë një shumë mbi 180.000.00 €, dhe për këtë pyes ish drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili është prezent këtu, a ka pasur ngrohje korrekte normale në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës, e nëse përgjigjja është po, atëherë kemi kolegë këshilltarë të Kuvendit të cilët punojnë në shkollën “ Naim Frashëri” e të cilët mund të na tregojnë se si ka qenë gjendja e ngrohjes gjatë sezonit të dimrit, pra të shpenzohet gjithë kjo shumë buxhetore dhe në fund të mos e marrin nxënësit atë që e meritojnë, mendoj se nuk është në rregull. E përmendi kolegu nga LVV-ja, te kodi 13509 ku shkruhet pajisje tjera në vlerë nën 1000 €, këtu kemi një koincidence ose kemi të bëjmë me diçka të qëllimshme, si është e mundur që përafërsisht ky kod dhe kjo shumë të përsëritet me një shumë pothuajse të njëjtë çdo vit, pra në vitin 2013 ky kod ka pas shumën për 17 € më pak, ose deri në raportin financiar të periudhës nëntëmuajore të vitit 2014 ky kod ka qenë i shpenzuar deri në vlerën 8000 €, pra për tre muaj trefishohet dhe arrin shumën 22,000.00 €, andaj kërkoj që nëse është e mundur, të evidentohet natyra dhe lloji i këtyre pajisjeve. Ne në parim jemi që mjetet buxhetore të shpenzohen drejt përmirësimit të jetës së qytetarëve, e jo vetëm të shpenzohen, shembull, mendoj se nuk është një kryefamiljarë i mirë në çiftë se ai e shpenzon rrogën pa i përmbushur nevojat e familjes, dhe në këtë aspekt ne si Komunë jemi si një familje, dhe nuk duhet të kemi dallime politike kur kemi parasysh interesat e qytetarëve.

z. Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, theksoi, dëshiroj të jap përgjigje konkrete rreth pyetjes së parashtruar nga këshilltari i LVV-së, e cila ka të bëjë me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve zyrtare. Jeni në dijeni se secila veturë e cila regjistrohet patjetër duhet t'i bëhet edhe sigurimi sepse përndryshe nuk mund të jetë e shfrytëzueshme për qarkullim në komunikacion, ndërsa lidhur me shumën e shpenzuar

për këtë çështje sqaroj se kompanitë e sigurimeve nuk i sjellin faturat menjëherë por në mënyra të ndryshme, ose i sjellin të gjitha të grumbulluara ose kohë pas kohe sipas rasteve kur ndonjë veturë i skadon afati i regjistrimit, do të thotë kompanitë nuk janë të obliguara t'i sjellin menjëherë posa të regjistrohet një apo më shumë vetura, por kjo bëhet kohë pas kohe varësisht rrethanave, dhe pagesat bëhen në bazë të atyre faturave.

Çështja tjetër e cila u ngrit nga parafolësi e që ka të bëjë me shpenzimin e mjeteve buxhetore për karburante të automjeteve zyrtare, unë ju rikujtoj se në kuadër të këtyre shpenzimeve përveç automjeteve të Administratës së Komunës bëjnë pjesë edhe automjetet zyrtare të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrës për Punë Sociale dhe Njësitit të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit, ku një numër i madh i këtyre automjeteve janë në gjendje jo të mirë teknike, por megjithatë jemi në procedurë e sipër për t'i shitur disa prej tyre të cilat nuk i plotësojnë kushtet për të qenë të shfrytëzueshme, veturat e reja të cilat janë blerë, sapo të kryhen të gjitha procedurat e regjistrimit të tyre ato do jenë të përdorshme për nevoja zyrtare. Andaj për çdo detaj që i intereson më shumë ndokujt, ne jemi të hapur që t'ju japim sqarime dhe lirshëm mund të më drejtoheni për gjitha shpenzimet që janë bërë në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, meqë u shtrua pyetja lidhur me furnizimin e shkollave me lëndë djegëse, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit sepse në atë kohë kam qenë drejtor, konkretisht do t'i përgjigjem këshilltarit z. Flakron Gashi i cili shtroi pyetje rreth nivelit ose cilësisë së ngrohjes në shkollën "Naim Frashëri" në Podujevë. Nuk ka munguar ngrohja, mirëpo problemi në atë shkollë qëndron se po edhe të mbahej ngrohja në funksion për 24 orë me siguri se ai objekt nuk do të mund të ngrohet në nivel të kënaqshëm sepse është objekt shumë i vjetër pa termoizolim dhe me dritare të vendosura ndoshta para 50 viteve, do të thotë se fatkeqësisht e gjithë ngrohja humb për shkak të vjetërsisë së madhe të objektit të shkollës, mirëpo fatmirësisht objekti i ri i shkollës është duke u punuar dhe punimet e vrazhda janë në përfundim e sipër, besoj se në shtator të këtij viti nxënësit dhe mësimmdhënësit e shkollës "Naim Frashëri" do të jenë në objektin e ri të shkollës ku shpenzimet do të jenë dukshëm më të vogla dhe cilësia e ngrohjes do të jetë dukshëm më e mirë.

Po ashtu këshilltari z. Haki Rudari shtroi pyetje lidhur me ngrohjen në shkolla përkatësisht për shpenzimet për dru për djegie në shkolla, realisht shpenzimet nuk kanë qenë më të mëdha se në vitin 2013 por në raport financiar del se shpenzimet kanë qenë më të mëdha, por në fakt janë më të vogla sepse në vitin 2014 nuk janë blerë 500 ton thëngjill ngase ka tepruar një sasi e mjaftueshme nga viti paraprak, pra sasia e blerë e druve ka qenë për afërsisht e njëjtë me vitin 2013 por nuk është blerë thëngjill në vitin 2014.

z. Haki Rudari, theksoi, i falënderoj drejtorët parafolës për sqarime, mirëpo unë nuk mora përgjigje për çmimin e druve dhe të derivateve, si dhe për rrugët "Xhafer Meta" dhe "Besnik Restelica" ku qytetarët kanë ankesa të shumta për kthimin e ujërave të zeza nga kanalizimet në oborret e shtëpive të tyre, kështu që unë nuk mora ndonjë sqarim.

Çështje tjetër është, në raport ceket se shpenzimet nga donatorët e jashtëm janë 34,960.00 € apo 9.05% nga buxheti i alokuar prej 386,336.00 €, andaj shtroj pyetje pse nga kjo shumë e mjeteve të alokuara është një realizim kaq i vogël, kur kemi parasysh që kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë shumë të mëdha.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, çështja e kontratave të lidhura nga ana e Departamentit të Prokurimit janë transparente dhe çmimi i druve, i thëngjillit apo i naftës është çmim të cilin e përcakton tregu, unë jam në dijeni se në vitin 2014 çmimi për

dru i lidhur me kontratë ka qenë rreth 37 € për m³, kurse çmimi i naftës për ngrohje është varësisht çmimit të berzës, dhe në bazë të kësaj lidhet edhe kontrata.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, lidhur me pyetjen që e bëri z. Haki Rudari rreth çështjes së donatorëve, unë edhe në fjalën hyrëse e thash se një pjesë e atyre mjeteve janë deponuar në llogarinë e Komunës në fund të muajit dhjetor dhe ato mjete janë në dispozicion për shfrytëzim për vitet 2015-2016, pra në tabelat në fagen shtatë të raportit janë të specifikuara të gjitha, ku 71,600.00 € janë donatorë të brendshëm përkatësisht për projektin e Vrellës së Revuçit i cila ka mbetur që disa vite mirëpo mjetet e qytetarëve janë duke u ruajtur në llogarinë e mirëbesimit të Bankës Qendrore të cilat barten nga viti në vit, andaj dalin si mjete të pashfrytëzuara, pastaj pjesa tjetër 34,000.00 € të shpenzuara janë 10 % i projektit, promovimi dhe zhvillimi i turizmit në liqenin e Batllavës, projekt i cili ka përfunduar në vitin 2013 por që 10% e mjeteve janë bartur në vitin 2014 pasi që është hartuar raporti i Auditorit të Jashtëm për projektin në fjalë, do të thotë është dashur një raport nga një auditorë i jashtëm i pavarur ekskluzivisht vetëm për projektin e Batllavës, dhe kur Komisioni European e ka pranuar si të tillë atëherë edhe ka bërë pagesën e 10% të shumës së projektit, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve e cila është në dispozicion do të shfrytëzohet në vitet 2015-2016 për projektin, Grumbullimi, ruajtja dhe përpunimi i pemëve dhe perimeve, me Komisionin European që do të fillon në këtë vit dhe që mendohet të përfundojë në fund të vitit 2016, prandaj nuk kanë mundur të shfrytëzohen këto mjete për arsye se me kontratë parashihet që të shfrytëzohen në vitet 2015-2016.

znj. Kumrie Hoti, theksoi, unë më parë shtrova pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, raporti i Auditorit të Përgjithshëm ka rezultuar me 10 të gjetura apo rekomandime, andaj nëse në vitin 2013 kishte rritje të obligimeve të papaguara për 31%, sa janë këto obligime në vitin 2014, pra të jemi në dijeni se a ka rritje apo zvogëlim të këtyre obligimeve të papaguara në vitin 2014, pyetje për të cilën kërkoj prapë përgjigje.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, rreth pyetjes së parafolësës unë nuk e pash të arsyeshme të përgjigjem apo të jap sqarime ngase parafolësja kryesisht foli për raportin e Auditorit Gjeneral për vitin 2013, kështu që do të ishte diskrepancë nëse ne sot kur kemi paraverës raportin financiarë për vitin 2014, të diskutojmë për raportin e Auditorit Gjeneral të vitit 2013, pra të gjeturat nga ky raport nuk ndërliken drejtpërsëdrejti me raportin financiarë për vitin 2014, por shumë shpejt do të kemi një raport nga Auditori Gjeneral për vitin 2014 të cilin do ta diskutojmë.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, lidhur me pyetjen e z. Kumrie Hoti e cila e ceku një rrugë në fshatin Revuç, është e vërtetë që është dëmtuar asfalti për afër 3.5 m², mirëpo arsyeja e kësaj është se në pjesën e dëmtuar frekuenton një operatorë i cili operon me një autobus dhe harku i autobusit prej 90 shkallë në hyrje – dalje të asaj rruge e ka dëmtuar skajin e rrugës, ndërsa operatori i cili i ka kryer punimet ka obligim ligjor por edhe me kontratë të garancionit për 3 vite, kështu që është informuar ai operator dhe ka marrë për obligim që do të rregullon atë pjesë të dëmtuar të rrugës në fshatin Revuç.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 13 vota kundër, dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Raporti Financiar për vitin 2014.

4. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

- Informatë për aktivitetet në vitin 2014
- Plani vjetorë i punës në vitin 2015

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në cilësinë e koordinatorit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar rreth kësaj çështjeje dhe i kemi rekomanduar Kuvendit që ta mbështetë këtë informatë dhe këtë plan vjetor të punës së KKS-së për vitin 2015. Unë personalisht kam bërë vërejtje rreth informatës, i gëzohem faktit dhe konsideroj se është një e arritur shumë e madhe që në vitin 2014 në Komunën e Podujevës nuk ka pasur raste ekstreme me fatalitet ose vdekje e të tjera sikurse që ka pasur në disa vite paraprake, mirëpo unë kam kërkuar që në atë informatë të përfshihet edhe Këshilli i Pajtimit i cili vepron në Komunën e Podujevës por edhe më gjerë, kuptohet jo në mënyrë institucionale, Këshilli i cili kryen një punë mjaftë të rëndësishme rreth konflikteve, ngatërresave dhe ngjarjeve të ngjashme mes njerëzve apo familjeve, pra konsideroj që është dashur të përfshihet në informatën e KKS-së për vitin 2014, në mënyrë që mos t'i humbet munda dhe puna atij Këshilli.

z. Bahri Selimi, theksoi, gjatë analizimit të informatës për vitin 2014 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, kemi hasur në disa gjëra të cilat është dashur të cekën në këtë informatë, ato janë, qysh në fillim thuhet, bazuar në nenin 9 paragrafi 1.8 të Udhëzimit Administrativ, dhe duke u bazuar në këtë nen bëhet kjo informatë, mirëpo duhet ta kemi parasysh se ky Udhëzim Administrativ që në fillim është shkëlur për arsye se në nenin dhe paragrafin e cekur thuhet që informimi i Kuvendit të Komunës duhet të bëhet dy herë brenda vitit për aktivitetet e KKS-së, e që ne si Kuvend deri më sot nuk kemi pasur asnjë informatë nga ky Këshill. Tjetër gjë e cila më ka bërë përshtypje është se në mbledhjen e dytë që është mbajtur 08.05.2014, kohë kur edhe kanë ndodhur disa vërshime në shumicën e fshatrave të Komunës së Podujevës, kurse në këtë informatë në një konstatim thuhet se shkaktarë të vërshimeve kanë qenë reshjet e mëdha të shiut dhe borës por edhe ngushtimi i shtretërve të lumenjve nga uzurpimet, mbjellja e drunjtëve, hedhja e mbeturinave e të tjera, pra sipas kësaj një pjesë e fajit iu hedhet edhe qytetarëve lidhur me ngushtimin e shtretërve të lumenjve, andaj unë konkretisht pyes Ekzekutivin e Komunës se sa është bërë për zgjerimin e shtretërve të lumenjve të cilët vazhdimisht janë duke na paraqitur probleme madje edhe në këtë kohë kur jemi duke debatuar për këtë çështje jemi në dijeni se shumica fshatrave janë duke u ballafaquar me vërshime dhe mendoj se ato prona për një kohë të gjatë nuk do të mund të punohen dhe të vihen në shfrytëzim për qytetarët. Në projektet prioritare për vitin 2014 kanë qenë të parapara 137,000.00 € për zgjerimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve, përkatësisht vetëm për zgjerim dhe pastrim kanë qenë 27,000.00 €, pastaj për zgjerimin e shtratit të lumit nga diga e liqenit të Batllavës deri në fshatin Lluzhan kanë qenë 65,000.00 € dhe për zgjerimin e shtratit të lumit Llap në fshatrat Lupç-Majac kanë qenë 45,000.00 €, mjete të cilat nuk janë shpenzuar për këtë çështje por janë rialokuar në dikastere tjera, gjë e cila të bënë të mendosh se shumë më rëndësi iu është dhënë disa projekteve tjera të papërfunduara dhe të cilat nuk kanë vlerë as

rëndësi sesa jeta dhe prona e qytetarëve. Pra kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës të na njoftoj se çka është bërë për rregullimin e këtyre shtretërve dhe a planifikohet të ndërmerret diçka në këtë drejtim në mënyrë që qytetarët të ndjehen më të sigurt nga vërshimet eventuale. Gjithashtu kam vërejtur në Planin vjetor të KKS-së një shkelje tjetër të Udhëzimit Administrativ përkatës ku thuhet, mbajtja e së paku gjashtë mbledhjeve gjatë vitit, e që në vitin 2014 janë mbajtur vetëm pesë mbledhje, pra Udhëzimi Administrativ e përcakton se Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi duhet të mbanë së paku gjashtë mbledhje në vit ku tri prej tyre duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit, kurse në vitin 2014 në gjashtëmujorin e parë është mbajtur vetëm një mbledhje e KKS-së. Prandaj bëra këto krahasime dhe vërejtje sepse sipas kësaj informate KKS në vitin 2014 ka bërë dy shkelje të Udhëzimit Administrativ përkatës.

z. Fidan Rekalu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës e falënderojmë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për punët, përkushtimin dhe aktivitetet e veta gjatë vitit 2014, dhe njëkohësisht i japim mbështetje të plotë në vazhdimin e punëve dhe aktiviteteve të tyre ashtu siç ka bërë deri më tani.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që nuk ka të lajmëruar këshilltarë të tjerë për diskutim, e hedh në votim Planin vjetor të punës së KKS-së për vitin 2015 me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa që në pikën 7 të planit, në kuadër të partnerëve të përfshihet edhe Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinarisë.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Plan i Vjetor i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2015 së bashku me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Propozimi i vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e propozimeve për korrigjimeve Planit Rregullues Urban “ Zona Qendër “ në Podujevë

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ku ndër të tjera paraqiti nevojën e korrigjimeve dhe plotësimeve kryesisht në aspektin teknik të Planit Rregullues Urban dhe harmonizimin me Ligjet në fuqi të planifikimit hapësinorë, sepse siç e ceku, asnjë leje e ndërtimit nuk mund të jepet qytetarëve pa u bërë korrigjimet dhe plotësimet sipas këtij propozim vendimi.

z. Flakron Gashi, theksoi, ne e kemi pranuar materialin përkatës, mirëpo fillimisht e pyes drejtorin parafolës se vendimi i Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë i cili është i bashkëngjitur në këtë propozim vendim a është i plotë apo jo sepse sipas këtij vendimi janë 5 faqe ndërsa janë printuar vetëm dy prej tyre ose mund të jetë gabim teknik. Çështja tjetër është se ky vendim është nxjerrë në muajin korrik 2012 dhe iu është dërguar organeve tona komunale kurse sot jemi në muajin mars 2015, në këtë aspekt drejtori parafolës e tha se nuk mund të lëshohet asnjë leje e ndërtimit pa u bërë korrigjimet dhe plotësimet e Planit në përputhshmëri me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të Planifikimit Hapësinorë, dhe për këtë pyes, ku kanë qëndruar organet komunale për më shumë se dy vite që nuk kanë ndërmarrë një hapë të tillë, kurse tani pas dy vite e gjysmë e kthejnë në Kuvend këtë vendim të inspektoratit të MMPH.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, lidhur me pyetjen që e bëri parafolësi rreth vendimit të Inspektoratit të MMPH, është e vërtetë se vendimi i cekur është nga muaji maj 2012 por në atë kohë ligji i Planifikimit Hapësinorë ka qenë tjetër, vërejtjet dhe rekomandimet që janë bërë Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në atë kohë nuk kanë qenë në harmoni me gjendjen faktike të Planit Rregullues Urban, konkretisht është dashur që në Plan të përfshihen edhe fasadat me ngjyra dhe pullazet e ndërtesave në projekte përkatëse, gjë të cilën e kemi diskutuar me Grupin punues të Inspektoratit të Ministrisë së cekur në muajin shkurt të këtij viti, pra Plani Hapësinorë ka pësuar ndryshime dhe për këtë shkak nuk mundemi ne tani të iniciojmë procedura për pajisje me leje ndërtimore sepse kemi të bëjmë me Planin e ri, andaj unë kam kërkuar të korrigjohet dhe plotësohet ky Plan.

z. Flakron Gashi, theksoi, drejtorin parafolës e dëgjova me vëmendje, mirëpo nuk e kam të kjashtë përgjigjen, u përmenden disa ligje të vjetra dhe ndryshimet e tyre, mirëpo besoj se të gjithë jemi në dijeni se para se të veprohet dhe të urdhërohet për veprimet që duhet të ndërmerren nga organet komunale ceket baza ligjore e vendimit, pra dy Ligjet ekzistuese të Planifikimit Hapësinorë dhe Udhëzimi Administrativ janë nxjerrë para datës së hartimit të këtij Plani dhe Inspektorati i Ministrisë urdhëron që të mos miratohen Plane Rregulluese Urbane që janë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinorë nr.2003/14 dhe Udhëzimin Administrativ për Planet Rregulluese Urbanistike nr.02/05 të datës 04.03.2005, do të thotë nuk është konsultuar fare baza ligjore kur është hartuar Plani i cekur, dhe unë pyes, që nga viti kur është nxjerr vendimi nga Inspektorati i MMPH me të cilin Komuna është urdhëruar të bënë ndryshimin e Planit Rregullues Urban, a ka pasur ndërtime, në çfarë karakteri dhe si janë ndërtuar objekte të ndryshme përgjatë rrugëve të përfshira në këtë Plan, shembull, kemi rastin afër banesave të Lesnës, në rrugën “Afrim Zhitia” ku është ndërtuar një objekt i banimit dhe investitori ka ndërtuar objektin për aq ari pronë sa ka pasur në posedim dhe nga i cili është rrezikuar prona private e një qytetari i cili banon afër atij objekti.

z. Haki Rudari, theksoi, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa në parim e kemi përkrahur këtë propozim vendim mirëpo sot ne si Grup do t'i ngrisim disa çështje, dhe atë, neni 2 i propozim vendimit thotë, korrigjimi i Planit Rregullues Urban të bëhet në pajtim me vendimin e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, çështje për të cilën pyes, Plani Rregullues Urban a është bërë në kundërshtim me ligjet e Ministrisë përkatëse, pastaj në nenin 4 thuhet, hartimin e propozimit të korrigjimeve të Planit përkatës e bënë Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, pyes, meqë involvohet kjo Drejtori a kemi kundërshtim apo mund të kemi degradim të ambientit. Çështja tjetër që ne kemi për të shtruar është vendimi i Inspektoratit të MMPH i cili thotë se Plani Rregullues Urban “Zona Qendër” të rikthehet me vendim nga asambleja komunale, pastaj thuhet të mos miratohen Plane Rregulluese Urbane që mund të jenë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinorë. Andaj sugjeroj Drejtoritë përkatëse të kenë kujdes sa i përket anës ligjore ngase përgjegjësia bie mbi ato, dhe pyes, çka mendohet të rregullohet me këtë revidim të Planit, dhe a ka Komuna ndonjë plan konkret për ndërtim në këtë pjesë dhe çka mund të kenë dobi qytetarët nga ky Plan.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit i cili pyeti se cila është dobia e qytetarëve me këtë propozim, unë them se për shkak se në kohën kur është bërë Plani është marrë gjendja faktike dhe gjithashtu ka gabime teknike sa i përket anës tekstuale dhe asaj grafike,

shembull, në një pjesë të qytetit është paraparë të ndërtohet P+7 kurse ndërtesa çift me atë ndërtesë është P+3 sepse është marrë gjendja faktike, ndërsa në anën grafike është çdo gjë në rregull. Prandaj edhe kam kërkuar që kjo çështje të harmonizohet sepse kemi një gjendje kontradiktore mes anës tekstuale dhe asaj grafike.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë në kohën kur është hartuar Plani Rregullues Urban kamë qenë drejtori i Drejtorisë përkatëse, dëshiroj të jap një sqarim rreth këtij Plani i cili është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, gjithashtu ky Plan ka qenë disa herë në diskutim publik ku të gjitha vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet e arsyeshme si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga ana e këshilltarëve të Kuvendit janë marrë para sysh dhe janë përfshirë në këtë Plan, mirëpo pas një kohe Inspektorati i Ministrisë përkatëse ka bërë disa vërejtje të vogla sa i përket parcelizimit, kështu që tani paraqitet nevoja që ne ta korrigjojmë këtë Plan, pra qëllimi është që të bëhen ato korrigjime në bazë të procesit të dhënë nga Inspektorati i cekur si organ i shkallës së dytë, dhe nuk mendoj se ka diçka që nuk duhet të votohet ky propozim vendim. Vlen të ceket se Vendimi i Kuvendit i asaj kohe me të cilin është miratuar ky Plan është vlerësuar i ligjshëm nga ana e Ministrisë përkatëse.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

6. Propozimi i vendimit për iniciimin e procedurës për revidimin e Planit Detaj Urbanistik të kompleksit Podujeva II

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, me këtë propozim kemi të bëjmë me pjesën “Podujeva II” e cila gjendet nga udhëkryqi apo rrethi i cili gjendet në rrugën Skënderbeu përkatësisht nga ura që ndanë lumin Llap e deri në magjistralen Podujevë-Prishtinë, pra Plani për atë zonë është miratuar në vitin 2006-2007, dhe në bazë të ligjit përkatës çdo 5 vite duhet të bëhet revidimi i tij, sot është e nevojshme të miratohet ky propozim vendim e pastaj për revidimin e Planit përkatës do të angazhohen kompani profesionale, pastaj para se ta miratojmë si dokument final do ta kemi edhe njëherë në Kuvend për të marr vendim për vënie në diskutim publik të atij Plani.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

7. Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e Teatrit Publik të Qytetit të Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një Vendim i cili është miratuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2012 dhe i cili është vlerësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me rekomandim që zbatimi i këtij vendimi të bëhet pasi të nxjerrët Rregullorja përkatëse nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe tani ajo veç është nxjerrë dhe nuk mendoj se kemi ndonjë problem për të miratuar këtë vendim, andaj nëse nuk ka të interesuar për diskutim, unë e hedh në votim këtë propozim i cili vetëm duhet të konfirmohet sot nga Kuvendi i Komunës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Vendimi për themelimin e Teatrit Publik të Qytetit të Podujevës.

8. Draft Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim 2015-2018

- Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, në cilësinë e pjesëmarrësit në kuadër të grupit punues për hartimin e kësaj Strategjie, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera shtoi, një përfaqësues i lartë i OSBE-së në Kosovë, pas përvojave që ka pasur në këtë fushë në disa shtete fqinje si Kroaci, Bosnje e të tjera dhe me njohuri të larta në fushën e komunikimit dhe informimit, ka qenë në një takim te Kryetari i Komunës dhe i ka rekomanduar që është mirë që Komuna e Podujevës të përfshihet në mesin e pesë Komunave tjera të Kosovës në projektin e OSBE-së për hartimin e Strategjisë trivjeçare për Informim dhe Komunikim me publikun. Gjithashtu kryesuesi informoi për punëtorinë dy ditore që është mbajtur në qytetin e Pejës ku kanë marr pjesë të gjitha grupet e tjera nga Komunitat pjesëmarrës në këtë projekt, punëtori në të cilën janë trajtuar mjaft tema të rëndësishme nga kjo fushë ku edhe ju është rekomanduar që Komunitat përkatëse në bazë të specifikave të tyre t'i hartojnë Strategjitë komunale për Informim dhe Komunikim me publikun duke mbajtur debate publike me qytetarë dhe grupe tjera të interesit, pastaj pas gjitha këtyre procedurave Strategjia duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës si një dokument final. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar për këtë draft Strategji dhe propozimin për vënie në diskutim publik, është caktuar data e mbajtjes së diskutimit publik dhe i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, e falënderoj Kryesuesin për informatat shitesë që i bëri, mirëpo me të marr materialin kam vërejtur Kryesuesin e Kuvendit në krye të këtij grupi, pastaj edhe një kolege këshilltare nga Kuvendi i Komunës dhe unë nuk e kontestoj askënd për pjesëmarrje si profesionistë të fushës në grupe apo komisione të ndryshme, mirëpo më bëri përshtypje ngase në qoftë se është në emër të Kuvendit të Komunës, dëshiroj të dijë se kur ka vendosur Kuvendi që ajo të jetë anëtare e atij grupi punues. Çështja tjetër që dua të them është se këtë draft Strategji e kam lexuar dhe analizuar me kujdes, por diçka që më ka rënë në sy është se në dokument synohet që të gjitha organet e Komunës për punën e tyre duhet t'i raportojnë Zyrës së Informimit, dhe në një formë zyrtari i Informimit na del goxha si një shef i shefave, deri sa unë konsideroj se Zyra e Informimit duhet të jetë ajo e cila e përcjell punën e organeve të Komunës, e jo të jetë e kundërta. Gjithashtu unë nuk kam vërejtur ndonjë ndryshim apo formë tjetër që do të përdoret sa i përket objektivave dhe synimeve për informim, përveç atyre të cilat përdoren si, ueb-faqja zyrtare e Komunës, tabela e shpalljeve e tjera. Sa i përket diskutimit publik mendoj se është një vlerë shitesë e çdo dokumenti dhe në parim nuk duhet të jemi kundër diskutimeve publike, por më bëri përshtypje ngase në shumë herë kemi pasur para vetës dokumente më të rëndësishme të cilat nuk i kemi hedhë në diskutim publik, çoftë ndonjë strategji zhvillimore të Komunës apo diçka të ngjashme, mirëpo mbase është menduar të mbahet diskutim publik për këtë draft Strategji duke qenë edhe kërkesë e OSBE-së, atëherë dakord le të jetë ashtu si është propozuar.

z. Flakron Gashi, theksoi, nuk kam çka të heqë asgjë nga diskutimi i parafolësit, por vetëm kam çka të shtoj më shumë rreth kësaj draft Strategjie për të cilën singlerisht mendoj se ai që e ka lexuar me vëmendje sigurisht se ka vërejtur se kjo Strategji është më shumë ilustrore se sa që ka diçka konkrete. Meqë është edhe Kryetari i Komunës prezent këtu, mendoj se duhet të ekzistoj vullneti politik në mënyrë që informohen qytetarët për mbarëvajtjen dhe aktivitetet e organeve komunale, por nuk mendoj se

është e nevojshme të nxjerrim strategji për një gjë të tillë. Jeni në dijeni se kemi bërë kërkesë që edhe audioincizimet tonike nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të Kuvendit të dalin në ueb-faqe zyrtare të Komunës, gjë e cila nuk ka ndodhur asnjëherë. Në këtë draft Strategji janë përmendur mjete ose metoda për të arritur deri te një komunikim me qytetarët, ueb-faqja zyrtare e Komunës, faqja zyrtare e Komunës në facebook, radiot lokale dhe youtube, e që unë nuk kam arritur ta kuptoj këtë gjë, andaj pyes, a ka nevojë që ne të nxjerrim Strategji që shefit të Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim t'ia bëjmë me dije se Komuna e Podujevës nuk i ka më 41 këshilltarë të Kuvendit, por i ka 35, e që në ueb-faqe zyrtare të Komunës figuron që janë 41 këshilltarë, pastaj a ka nevojë që të ketë Strategji për t'iu treguar se KF Besiana dhe KF Hysi nuk janë në Superligën e Kosovës dhe se KF Llapi është në ligën e parë, gjithashtu pyes, a ka nevojë të ketë Strategji që këtij Grupi punues t'jua bëjmë me dije se për Komunën e Podujevës në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë nuk aludohet më shifra rreth 135,000 banorë por duhet të ketë shifra konkrete zyrtare sipas regjistrimit të fundit që është bërë e që është rreth 89,400 banorë, po ashtu a është e rëndësishme që të ketë një Strategji ku sipas saj në Podujevë ekzistojnë vetëm dy restorante, Ora dhe Nobel, të paktën besoj se të gjithë jemi në dijeni se ekziston një numër më i madh i tyre. Çështja tjetër që dua të ceku ka të bëjë me faqen zyrtare të Komunës në facebook e cila më shumë i ngjan një faqeje të një partie politike, dhe mos të harrojmë se Komuna është e të gjithë qytetarëve e jo vetëm e LDK-së, dhe në atë faqe pasqyrohen vetëm vizitat protokollare të Kryetarit, madje madje absurditeti më i madh është që prej faqes zyrtare të Komunës në facebook i bëhet like (pëlqim) faqes së Kryeministrit z. Isa Mustafa, gjë për të cilën konsideroj se është absurditet i skajshëm dhe nuk di se a ka nevojë të nxjerrët një Strategji për këto gjëra që i ceka. Mandej në hyrje të objektit të Komunës ekziston një televizion i cili shërben si një monitor i cili ka qenë donacion nga OSBE por që nuk është funksional dhe ka kohë të gjatë është i fikur, pastaj a ka këndë të ankesave të qytetarëve, sigurisht se jo, cilat janë broshurat ose fletëpalosjet me të cilat qytetarët janë njoftuar për aktivitetet e Komunës për një vit, sa unë jam në dijeni asnjë fletëpalosje nuk është bërë me përjashtim të fletushkave për regjistrimin e pronës, e që është mbështetur nga OSBE. Prandaj në fillim e thash se duhet të ketë vullnet politik që qytetarët të informohen sepse nga të gjitha këto gjëra të cilat janë postuar në faqe zyrtare të Komunës dhe në facebook, a është rritur ose a janë sensibilizuar qytetarët për rëndësinë rreth pagesës së taksave, tatimit në pronë, ruajtjes së ambientit, e të tjera, ose ose në faqe zyrtare të Komunës, te kategoria e lajmeve nuk bëhet njoftimi se qytetarët kanë të drejtë dhe munden të jenë pjesëmarrës të heshtur në një seancë si kjo e Kuvendit, por në një link të faqes vetëm skanohet thirrja zyrtare e seancës, pra nuk është lajm apo thirrje e drejtpërdrejt për qytetarët që të marrin pjesë në seanca të Kuvendit që të njoftohen për të arriturat apo jo të arriturat e kësaj Komune. Pra pse e ceka se duhet të ketë vullnet politik, Kryesuesi i Kuvendi në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, përkatësisht neni 28 thotë, Kryesuesi i Kuvendit mund t'i informoi televizionet qoftë edhe ato nacionale, gazetatat, gazetarët dhe portalet informative, unë pyes Kryesuesin a është bërë ndonjëherë ky njoftim, gjithashtu neni 56 i Rregullores thotë, këshilltarëve të Kuvendit së bashku me procesverbalin e shtypur duhet t'iu jepet edhe CD-ja me regjistrim tonik, gjë të cilën nuk e kemi pranuar asnjëherë, sepse të paktën do të mundnim t'i shkëpusim edhe qëndrimet e juaja edhe qëndrimet tona.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahim këtë draft Strategji e cila nënkupton vullnetin politik të Ekzekutivit të Komunës për të qenë sa më afër qytetarëve dhe për t'iu ofruar sa më shumë informata qytetarëve si dhe për t'iu mundësuar qytetarëve të kenë më shumë mundësi për t'i shprehur vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet e tyre për të cilat ata mendojnë se duhet të jenë më afër punës dhe aktiviteteve të Ekzekutivit të Komunës. Prandaj ne e përkrahim një Strategji të tillë dhe njëkohësisht e mbështesim propozimin e vendimit për vënie në diskutim publik dhe mendojmë se është e nevojshme të ketë një diskutim publik për këtë draft Strategji në mënyrë që të merren parasysh edhe mendimet e qytetarëve, mediave, shoqërisë civile, grupeve të ndryshme të interesit e tjera, dhe pastaj ne si Kuvend do të kemi mundësi edhe njëherë që me rastin e miratimit final të këtij dokumenti të bëjmë ndryshime përmes vërejtjeve, mendime, propozimeve dhe sugjerimeve të ndryshme me qëllim që dokumenti të jetë sa më i pasur.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi diskutuar këtë draft Strategji, përkatësisht kemi pyetur se a ka bazë ligjore të vihet në diskutim publik ky dokument, nga Kryesuesi i Kuvendit kemi marrë përgjigje se nuk ka pengesë ligjore për këtë, ne i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm sepse kemi menduar se është me rëndësi të merren edhe opinionet e qytetarëve, pastaj ky dokument do të vie prapë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final ku do të mund të japim vërejtje, plotësime dhe sugjerime të cilat mund të inkorporohen në dokumentin final. Pra mendoj se nuk kemi nevojë që ne sot të mos i japim miratimin këtij propozim vendim për diskutim publik, sepse ai dokument do të silltet prapë në Kuvend dhe atëherë ne mund të debatojmë më gjatë ngase siç e tha edhe parafolësi z. Flakron Gashi kjo Strategji është në të mirë të të gjithë qytetarëve.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi nga radhët e LVV-së që nga fillimi i këtij mandati kemi kërkuar transparencë dhe llogaridhënie nga të gjithë, por megjithatë ajo nuk është bërë, e përmendi edhe kolegu se kemi pas një politizim të informimit nga ana e njerëzve të Komunës. Sa i përket Grupit punues të kësaj draft Strategjie mendoj se fillimisht është dashur të diskutohej në Kuvendin e Komunës në mënyrë që të merren propozimet edhe nga Grupet e subjekteve politike të Kuvendit, ndërsa neve si këshilltarë të Kuvendit na ka ardhur si e gatshme kjo çështje. Duke u nisur nga aspekti se ne jemi për një informim të saktë, të drejtë dhe jo politik, në parim e përkrahim por mendojmë se është dashur që në vazhdim të involvohen edhe faktorë të tjerë dhe grupe tjera.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që nuk ka të lajmëruar këshilltarë të tjerë për diskutim, unë e hedh në votim këtë propozim vendim për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë komunale për informim dhe komunikim 2015-2018 sipas materialit të dërguar dhe rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht diskutimi publik të zgjat 15 ditë kurse debati me publikun të mbahet më 15.04.2015.

Pas votimit u konstatua se me 33 vota për, 1 votë të përmbajtur dhe asnjë votë kundër u miratua ky propozim vendim.

9. Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës të Arif Arifit nga Podujeva)

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

10. Të ndryshme

znj. Adelinë Stublla, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, a jeni në dijeni se në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë, pikërisht në repartin e Stomatologjisë ka material për rregullimin e dhëmbëve por që ka një kohë bukur të gjatë që këta material nuk futet në funksion duke mos marrë përgjegjësi asnjëri prej mjekëve, dhe sipas jush, a duhet që t'i del afati atij materiali pa u futur fare në përdorim, dhe a është në rregull që pacientët të kthehen prapa pa i marrë shërbimet e duhura dhe a është kjo neglizhencë e punës së mjekëve si pasoj e punës së tyre në ordianca private. Pra a duhet të ndodh kjo në shëndetin oral kur dihen kërkesat dhe nevojat e shumta të qytetarëve.

z. Flakron Gashi, theksoi, dua të ngris një shqetësim në mënyrë që të vlejë si informatë për organet e Komunës, fjala është për një zonë në mes fshatrave Dobërdol – Llaushë, ku ka filluar të krijohet një deponi e egër e mbeturinave madje duke hedhur edhe kafshë të ndryshme të ngordhura, dhe mos të harrojmë se afër atij vendi rreth 200 metra ndodhen 4-5 familje të cilat rrezikohen nga ajo deponi, andaj ju bëj apel organeve komunale dhe Drejtorisë përkatëse që të ndërmarrin masa..

z. Haki Rudari, theksoi, unë kam dy pyetje për dy Drejtori të Komunës;

1-për Drejtorinë e Arsimit, sa mësimdhënës janë në Komunën e Podujevës të cilët japin mësim dhe që nuk janë me profesion adekuat.

2-për Drejtorinë e Inspeksionit, çka është ndërmarrë nga kjo Drejtori për mbrojtjen e ambientit, përkatësisht në fshatin Drazhnje është duke u bërë një punë e cila është duke degraduar ambientin.

Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12;00

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-39128
Podujevë,
31 mars 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**